

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, kërkon nga Kuvendi i Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M **PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KOMPANISË RAJONALE TË** **MBETURINAVE "PASTRIMI"SH.A**

- I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **25,000.00 €** (njëzet e pesë mijë) euro, për subvencionimin e familjeve në asistencë sociale të Komunës së Lipjanit për pagesën e borgjeve përkatësisht kryerjen e pjesërishme të obligimeve të grumbullura deri me datën 31.10.2022, që familjet në asistencë sociale kanë ndaj KRM "Pastrimi" për ofrimin e shërbimeve për marjen e mbeturinave .
- II. Obligohet KRM "Pastrimi" që më së largu brenda afatit 45 (katërdhjetë e pesë) ditësh nga dita e ekzekutimit të pagesës të sjellë Raport financiar për Kryetarin e Komunës duke i bashkëngjitur regjistrin e familjeve të subvencionuara.
- III. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale mban përgjegjësinë për hartimin e regjistrit të familjeve në asistencë sociale në koordinim me Qendrën për Punë Sociale në Lipjan.

IV. Mjetet financiare për ekzekutimin e këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2023 , fondi burimor :21/613/16003/200/00000/0111 në xhirollogarinë bankare të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave " Pastrimi"SH.A.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

VI. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozimin- Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019.

Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Propozim - Vendimi me qëllim të subvencionimit të familjeve në asistencë sociale të Komunës së Lipjanit për pagesën e borgjeve përkatësisht kryerjen e pjesërishme të obligimeve të grumbullura deri me datën 31.10.2022 që familjet në asistencë sociale kanë ndaj KRM "Pastrimi", për ofrimin e shërbimeve për marjen e mbeturinave sipas kërkesës të KRM " Pastrimi" 01-400/01-36373 të datës 17.07.2023 në të cilën theksohet se borgji i terësishëm për 581 ekonomi familjare është rreth 60.000 € (gjashtëdhjetë mijë euro).

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400/01-36520

Lipjan, më 17.07 2023

KRYETARI I KOMUNËS


Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 17.07 2023		
Priniljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-400/01-36373		

Datë:	17.07.2023
Për:	Kryetarin e Komunës Z.IMRI AHMETI
Nga:	Xhelal Krasniqi - Menaxher KRM Pastrimi – Nj.O.- Lipjanë
Lënda:	Kërkes per fshirjen e borgjeve te rasteve sociale



Kërkojm nga Kryetari I Komunes z.Imri Ahmeti që te merr parasysh kerkesen e K.R.M.Pastrimi NJ.O.Lipjan për fshirjen e borgjeve te rasteve sociale ne Komunen e Lipjanit ku ne si kompani ne vazhdimsi ju kemi kryer sherbim pa dallim edhe pse te njejtit nuk kan kryer obligimet ndaj kompanis per ket kemi edhe listen e familjarve te deshmuar me faktur deri ne mujin tetor 2022 qe arrin shumen e rreth 60.000 € kjo list eshte perpunuar dhe verifikuar ne kordinim me zyrtaret e qendres per raste sociale.

Vlen te ceket se jan te perfshir veten 581 ekonomi familjare ndersa,rastet tjera nuk jan pergjigjur ne thirrjet tona duke u bazuar ne numrat e telefonit qe ishin ne listen e siguruar nga qendra sociale.

Shpresojm se kerkesa jon do te mirret parasysh dhe do te kemi pergjigje pozitive.